



Në krye të Instancës është:

Avokati i Popullit, **Jorgos Kaminis**, asistent profesor i së drejtës kushtetuese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Athinës.

Avokati i Popullit ndihmohet nga pesë Ndhmës Avokatë:

- **Andreas Taqis**, Avokat, Ekspert i Posaçëm tek Avokati i Popullit, në krye të Ciklit për të Drejtat e Njeriut.
- **Patrina Paparigopullu**, avokate, Doktore e së Drejtës, Eksperte e Posaçme e së Drejtës së Sigurimeve Shoqërore në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Athinës, në krye të Ciklit të Mbrojtjes Sociale.
- **Krisi Haxhi**, avokate, në krye të Ciklit Kualiteti i Jetës.
- **Kalopi Spanu**, ndihmës-profesore e Shkencës së administratës e Universitetit të Athinës, në krye të Ciklit të Marrëdhënieve Shtet-Qytetar.
- **Jorgos Moskos**, jurist, kriminalist, në krye të Ciklit të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve.



Me Avokatin e Popullit mund
të komunikoni me mënyrat e
mëposhtme:

Me telefon:

801 11 25 000

(pa pagesë për 24 orë)

210 728 96 00

(nga e Hëna deri të Prëmtë 08:30-14:00)

Me fax:

210 729 21 29

Me postë:

**Haxhjani Meksi 5,
KP 115 28 Athinë**

Me e-mail:

communication@synigoros.gr

Në internet

www.synigoros.gr

Ç'është Avokati i Popullit?



Ç'është Avokati i Popullit?

Avokati i Popullit është një Instancë e Pavarur e sanksionuar nga Kushtetuta. Funkcionon nga 1 tetor 1998 dhe u nënshtrohet dispozitave të Ligjit 3094/03. U shërben falas të gjithë qytetarëve.

Cili është misioni i tij?

Avokati i Popullit ndërhyt midis administratës shtetërore dhe qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre, respektimin e ligshmërisë dhe luftimin e drejtimit të keq. Avokati i Popullit ka gjithashtu si mision të tij mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Si organ ndërmjetësues, Avokati i Popullit formulon vërejtjet dhe propozimet për administratën shtetërore. Nuk imponon sanksionime dhe nuk anulon aktet e kundraligjshme të administratës shtetërore.

Ankesat që parashtrojnë qytetarët shqyrtohen sipas uniteteve tematike të ndara në pesë Cikle aktivitetesh: të Drejtat e Njeriut, Mbrojtja Sociale, Kualiteti i Jetës, Marrëdhëniet Shtet-Qytetar, të Drejtat e Fëmijëve.

Kush mund t'i drejtohet Avokatit të Popullit?

Çdo shtetas grek ose i huaj që jeton në Greqi ose jashtë saj dhe shkëmbehet me shtetin grek. Në mënyrë të veçantë, për shkeljet e të drejtave të fëmijëve, te Avokati i Popullit mund të drejtohet vetë fëmija e interesuar, prindi ose një person i afërm si dhe çdo person i tretë që ka konstatuar drejt për së drejti shkeljen e së drejtës së fëmijës.

Po këto vlejnjë edhe për personat juridike ose për bashkime personash.

Për ç' arsye?

- Kur veprimet ose mosveprimet e administratës shtetërore shkelin një të drejtë ose një interes të ligjshëm të qytetarit. Sido qoftë, qytetari duhet më përpara t'i drejtohet organit shtetëror të implikuar.
- Kur veprimet ose mosveprimet e administratës shtetërore ose të privatëve shkelin një të drejtë të fëmijës.



Për cilat çështje mund të ndërhyjë Avokati i Popullit?

Ndërhyn në problemet që has qytetari gjatë kontaktit me administratën shtetërore, siç janë:

- dhënia me mangësi ose refuzimi për dhënien e informatave.
 - vonesë e tepëruar në plotësimin e kërkesave
 - shkelje të ligjit, procedurë e kundraligjshme
 - diskriminime të paligjshme në dëm të qytetarëve
- Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve Avokati i Popullit ndërhyn në çështje që lidhen me privatë, persona juridikë ose fizikë, që shkelin të drejtat e fëmijëve.

Për cilat raste është kopetent Avokati i Popullit?

Është kopetent për kontradikta të qytetarit me: shërbimet

- shtetërore
- të vetqeverisjes lokale (komunat bashkitë, prefekurat e qarkut)
- të personave të tjerë juridikë të së drejtës shtetërore
- të personave juridike të së drejtës private, të ndërmarrjeve dhe të organizatave që kontrollohen nga shteti ose nga personat juridikë të së drejtës shtetërore.
- veçanërisht për rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, Avokati i Popullit është kopetent për akte ose mosveprime të enteve shtetërore dhe të privatëve, të personave fizikë ose juridikë.

Për cilat raste nuk është kopetent?

Nuk është kopetent:

- kur kanë kaluar më shumë se 6 muaj nga data kur qytetari u informua për aktin e kundraligjshëm ose mosveprimin e administratës shtetërore që lidhet me të.
- për dhënien e informatave dhe të këshillave ligjore.

Gjithashtu nuk është kopetent:

- për kontradikta private
- për çështje që lidhen me statusin e punonjësve të personelit të shërbimeve shtetërore, për mbrojtjen kombëtare dhe sigurimin, politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit, për sigurimin e shtetit.
- për çështje që priten të gjykohen nga gjykatat.
- për akte të autoriteteve gjyqësore, të Avokaturës së Shtetit të enteve të pavarura, të personave juridike fetare të së drejtës së shtetit.
- për akte të Ministrave dhe të Zëvendësministrave në lidhje me administrimin e funksionimit politik.

Si parashtrohet kërkesa?

- Personalisht në zyrat e Avokatit të Popullit, rruga Haxhijani Meksi nr. 5 K.P. 115 28 Athinë, gjatë ditëve dhe orëve të punës (08:30 - 14:00)
- me postë në adresën e mësipërme
- me fax në numrin 210 729 2129

Ç'farë duhet të përmbajë kërkesa?

- Identitetin e plotë dhe të saktë të personit të interesuar.
- nënshkrimin e personit të interesuar.
- përshkrimin e shkurtër të problemit
- kërkesën e personit të interesuar
- shërbimin shtetëror të implikuar ose, në rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, privatin e implikuar.
- veprimet që kanë paraprirë dhe përfundimet e tyre
- çdo fakt ose informatë që mund të ndihmojë për shqyrtimin e çështjes (shih modularin e bashkëngjitur)

Cilat faza ndjek procedura e shqyrtimit të kërkesës?

Çdo kërkesë:

- protokollohet dhe i ngarkohet një ekspert shkencor (faza e parë)
- kontrollohet për sa i përket kopetencave të Instancës (faza e dytë)
- gjatë shqyrtimit të kërkesës kërkohet mendimi i shërbimit të implikuar dhe i qytetarit të interesuar (faza e tretë)
- mbas përfundimit të shqyrtimit dhe në rast se e kërkon natyra e problemit, hartohet raporti i cili i bëhet i njohur ministrit kopetent dhe dikastereve kopetente (faza e katërt)
- Avokati i Popullit ndërmjetëson me çdo mjet të mundshëm për zgjidhjen e problemit të qytetarit (faza e pestë)

Në ç'mënyrë dhe nga kush informohet qytetari për kërkesën e tij?

- Në fazën e parë, me shkresë të Instancës, ku shënohet numri i protokollit, emri dhe telefoni i ekspertit shkencor që merret me çështjen
- në vazhdim, nga eksperti shkencor i çështjes, me shkrim, me telefon ose edhe me takim personal.